



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 405 prot.

Tiranë, më 13.04.2018

V E N D I M

Nr.29, datë 13.04.2018

**PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 238,
DATË 13/12/2017, NË NJËSINË E VETËQEVERISJES VENDORE BASHKIA
MALIQ**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil mbikëqyr, kryesisht ose me kërkesë të institucioneve, zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civil, nxjerr vendime paralajmëruese në rast se konstaton parregullsi dhe përcakton detyra konkrete për rregullimin e situatës,

Për këtë arsye:

Në zbatim të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenet 11/1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues Nr. 238, datë 13/12/2017, të Komisionerit,

VENDOSA:

1. Fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 238, datë 13.12.2017, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Maliq dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”.
2. Ngritjen e grupit të punës, me këtë përbërje:

1. Gentiana Biku

Inspektor, në Drejtorinë e Inspektimit dhe
Hetimit Administrativ

2. Migena Haznedari

Specialist, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe
Marrëdhënieve me Jashtë

3. Ky proces do të fillojë me paraqitjen e grupit të punës në subjekt dhe grumbullimin e të dhënave që materializojnë zbatimin e vendimit, në datat **24.04.2018 - 26.04.2018**.
4. Me përfundimin e verifikimit të akteve, grumbullimit të dokumentacionit dhe të dhënave në subjekt, grupi i punës do të vijojë me përpunimin e të dhënave. Akti i konstatimit, procesverbali i mbajtur në subjekt, si dhe dokumentacioni i administruar, lidhur me zbatimin e vendimit të Komisionerit, do t'i paraqiten për të vijuar procesin Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, brenda datës **27.04.2018**. Relacioni duhet të përpilohet deri në datën **09.05.2018**. Më pas do t'i paraqitet për miratim Komisionerit, dhe më tej, do të hartohet vendimi për përmbylljen e procesit, brenda **3** ditëve.
5. Vendimi i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për përmbylljen e procedimit administrativ (*verifikimit*) do t'i dërgohet subjektit të mbikëqyrur, Bashkisë Maliq dhe Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.
6. Ngarkohet Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, që të marrë masat për realizimin e procesit, duke filluar me njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes në përputhje me nenin 42, të Kodit të Procedurave Administrative dhe të akteve që janë pjesë e këtij vendimi.
7. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse që të sigurojë mbështetjen e grupit të verifikimit me logjistikë, për vijimin normal të procesit, në përputhje me programin e miratuar.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 405/1 prot.

Tiranë, më 13.04.2018

MIRATOHET

Pranvera STRAKOSHA

KOMISIONER

PROGRAM VERIFIKIMI

(Për verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Komisionerit Nr. 238, datë 13.12.2017, 'Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Maliq dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë'.)

- 1. Subjekti i mbikëqyrjes:** **BASHKIA MALIQ**
- 2. Objekti i verifikimit:** Zbatimi i Vendimit paralajmëruar Nr. 238, datë 13.12.2017, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Maliq dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
- 3. Baza ligjore:** Neni 14, i ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe Rregullorja "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

- 4. Afati i verifikimit:** Verifikimi do të kryhet në institucion në datat 24.04.2018 - 26.04.2018.
- 5. Procedura që do të ndiqet:** Për parregullsitë e konstatuara do të mbahet akti i konstatimit, procesverbal administrativ, i cili nënshkruhet nga grupi i verifikimit dhe personat përgjegjës, si dhe do të merret kopja e dokumentacionit përkatës, vërtetuar nga sekretaria e institucionit.
- 6. Grupi i punës:**
- | | |
|----------------------------|---|
| 1. Gentiana Biku | Inspektore, Drejtorja e Inspektimit dhe Hetimit administrativ |
| 2. Migena Haznedari | Specialiste, Drejtorja e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë |
- 7. Dokumentimi i rezultateve të verifikimit:** Në përfundim të procesit të verifikimit do të përgatitet relacioni përkatës nga Drejtorja e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, bazuar në aktin e konstatimit dhe procesverbali i mbajtur në subjektin e verifikuar, si dhe do të administrohet dokumentacioni provues. Më pas do të hartohet vendimi përfundimtar i procedurave përmbyllëse të verifikimit të zbatimit të vendimit, i cili do të dërgohet institucionit (*n.q.s vendimi nuk është zbatuar, Komisioneri do të zbatojë kompetencën e parashikuar në nenin 15, pika 2, të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar*).

DREJTIMET E VERIFIKIMIT

- I.** Si janë zbatuar, detyrat e lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Nr. 238, datë 13.12.2017, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Maliq dhe paralajmërimit të institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*, nga ana e Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit të mbikëqyrur. Në këtë rast, verifikimi do të realizohet duke pasur parasysh nivelin e zbatimit të urdhërimeve në vendimin paralajmërues, si më poshtë, duke administruar kopje të akteve që materializojnë zbatimin e vendimit:
- 1.** *Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Maliq, të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit dhe të rregullojë pasojat, duke ndërprerë marrëdhëniet financiare me institucionin, për punonjësit e emëruar në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si më poshtë:*

- ✓ ******, emëruar me aktin administrativ nr. 294, datë 16.06.2016, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin e punës, “Specialist/Arkivist, në Drejtorinë Juridike dhe të Prokurimeve”, pranë Bashkisë Maliq.*
- ✓ ******, emëruar me aktin administrativ nr. 32, datë 19.05.2014, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin e punës, “Specialiste e Ndhmës Ekonomike, në Sektorin e Mirëqenies Sociale”, pranë Bashkisë Maliq.*
- ✓ ******, emëruar me aktin administrativ nr. 97, datë 28.03.2017, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin e punës, “Specialiste për Emergjencat Civile, në Sektorin për Emergjencat Civile, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Strehimit”, pranë Bashkisë Maliq.*
- ✓ ******, emëruar me aktin administrativ nr. 343/15, datë 22.07.2016, të Kryetarit të Bashkisë në pozicionin e punës, “Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Mbledhjes së Taksave, në Drejtorinë e të Ardhurave”, pranë Bashkisë Maliq.*
- ✓ ******, emëruar me aktin administrativ nr. 454, datë 11.10.2016, të Kryetarit të Bashkisë në pozicionin e punës, “Punonjës Social/Specialist, në Njësinë Administrative, Gorë”, pranë Bashkisë Maliq.*

Këto pozicione pune duhet të të shpallen të lira, për t`u plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit për nëpunësin civil.

2. *Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Maliq, të rregullojë pasojat e paligjshmërisë në rastin e procedurës së ngritjes në detyrë nga jashtë shërbimit civil, për plotësimin e pozicionit të punës, “Përgjegjës Tatim-Taksash, Regjistrim+Llogaritje, në Zyrën e Tatim Taksave, Njësia Administrative Pirg”, ku janë lejuar shkelje ligjore, të cilat kanë të bëjnë me faktin se konkurrentja që ka fituar në këtë procedurë, nuk i plotësonte kërkesat e veçanta të vendit të punës.*

Njësia përgjegjëse, për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në këtë rast, duhet të ndjekë hapat si më poshtë:

- ✓ *Të konstatojë menjëherë si akt administrativ absolutisht të pavlefshëm aktin e emërimit, nr. 1450 prot., datë 20.03.2017, të punonjës *****, në pozicionin e punës “Përgjegjës Tatim-Taksash, Regjistrim+Llogaritje, në Zyrën e Tatim Taksave, Njësia Administrative Pirg, në Bashkinë Maliq”, si dhe të gjitha fazat e procedurës ligjore për ngritjen në detyrë, të zhvilluar në këtë rast, për plotësimin e këtij pozicioni pune.*

- ✓ *Të rregullojë pasojat duke ndërprerë marrëdhënien e punës dha asaj financiare, me pozicionin e punës “Përgjegjës Tatim-Taksash, Regjistrim+Llogaritje, në Zyrën e Tatim Taksave, Njësia Administrative Pirg”, për punonjësen ***** dhe të shpallë si të lirë, për ta plotësuar më tej në përputhje me kërkesat ligjore, e në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Maliq, pozicionin në fjalë.*
- 3.** *Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Maliq, të rregullojë pasojat e paligjshmërisë në rastin e procedurës së transferimit të nëpunësve civilë në kuadër të ristrukturimit të institucionit, ku janë lejuar shkelje ligjore, të cilat kanë të bëjnë me faktin se në 2 raste, nga njësia përgjegjëse është përdorur në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, instituti i transferimit në shërbimin civil, në vend të institutit të pranimit në shërbimin civil, nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.*

Njësia përgjegjëse, për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në këtë rast, duhet të ndjekë hapat si më poshtë:

- ✓ *Të konstatojë menjëherë si akt administrativ absolutisht të pavlefshëm, aktin e transferimit nr. 22 prot., datë 31.08.2015, të punonjësit *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Mirëqenies Sociale”.*
 - ✓ *Të konstatojë menjëherë si akt administrativ absolutisht të pavlefshëm aktin e transferimit nr. 3430 prot., datë 22.07.2016, të punonjëses *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Aseteve, në Drejtorinë Financës dhe Buxhetit”.*
 - ✓ *Komisioni i Ristrukturimit, në përputhje me përcaktimet e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe parashikimet e pikës 16, të Kreut III, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, të rregullojë pasojat duke bërë sistemimin e të dy punonjësve të mësipërm në një pozicion të së njëjës kategori (Specialist), pozicione të cilat i mbanin në momentin e ristrukturimit të institucionit.*
 - ✓ *Të shpallë si të lira, pozicionet e punës “Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Mirëqenies Sociale, në Drejtorinë Juridike dhe Prokurimeve” dhe “Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Aseteve, në Drejtorinë Financës dhe Buxhetit”, për t'i plotësuar më tej në përputhje me kërkesat ligjore, e në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Maliq.*
- 4.** *Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Maliq, të plotësojë dosjen e personelit të çdo nëpunësi civil, duke përfshirë në të, të gjitha dokumentet dhe të dhënat sipas lidhjeve 1 e 2, pjesë e vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit*

qendror të personelit”, si dhe ato të evidentuara në mungesë në tabelën aneks nr. 2, e cila është pjesë e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

5. *Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 30 ditë nga marrja dijani për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e materializuara në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.*

- II. Në rast të konstatimit të moszbatimit të pjesshëm apo të plotë të vendimit të Komisionerit, do të mbahet procesverbal konstatimi, i cili do të nënshkruhet nga grupi i punës dhe personi përgjegjës.

Aneks i programit: Aktet administrative që duhet të vihen në dispozicion të grupit të verifikimit.

Në vijim të programit të verifikimit, më poshtë po rendisim aktet që duhet të vihen në dispozicion të grupit të verifikimit për të përfunduar këtë proces.

1. Provat shkresore të cilat vërtetojnë zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me vendimin paralajmërues.
2. Materiale të tjera të cilat do të konsiderohen të domosdoshme për kryerjen e verifikimit nga grupi i punës.

**DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE
DHE E MARRËDHËNIEVE ME JASHTË**

Enkelejda HEBIBASI

DREJTOR